



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Shpallje për vend të lirë pune

Pozita:	Zyrtar i Kontrollit të Brendshëm
Organizata:	Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)
Lokacioni:	Prishtinë (Republika e Kosovës)
Data e shpalljes së konkursit:	21.11.2022
Data/ora e mbylljes:	05.12.2022, 16:00 (koha lokale)
Lloji dhe kohëzgjatja e kontratës:	Kontratë pune me orar të plotë për një periudhë të caktuar kohore (3 vjet) me mundësi vazhdimi
Periudha provuese:	3 muaj
Kur pritet të fillojë marrëdhënia e punës:	Brenda dy javësh pas nënshkrimit të kontratës së punës dhe jo më vonë se 15.01.2023 (cilado datë të jetë e para)

A) Rrethanat organizative

Me miratimin e Ligjit Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë (LEE), Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) është themeluar si entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, në mbështetje të objektivave të politikës për Eficiencë të Energjisë së Republikës së Kosovës, duke promovuar, mbështetur dhe zbatuar masat e eficiencës së energjisë, si dhe duke tërhequr dhe menaxhuar burimet financiare në mënyrë që të financojë dhe zbatojë projekte investimesh në fushën e Eficiencës së Energjisë në një mënyrë të qëndrueshme.

Zyrtari i Kontrollit të Brendshëm punësohet nga Drejtori Menaxhues i FKEE-së për një mandat që nuk i kalon tri (3) vjet, me mundësi të ri-emërimit. Ai / ajo raporton te Drejtori Menaxhues i FKEE.

B) Roli dhe përgjegjësitë kryesore

Nën mbikëqyrjen e Drejtorit Menaxhues, Zyrtar i Kontrollit të Brendshëm është përgjegjës për ekzekutimin me cilësi të lartë dhe të koordinuar të detyrave / aktiviteteve të besuara atij / saj nga Drejtori Menaxhues dhe shpërndarjen e rezultateve që kanë të bëjnë me këto detyra / aktivitete në kohë. Zyrtar i Kontrollit të Brendshëm është përgjegjës për përkthimin e njohurive dhe përvojave në fushën e Kontrollit të Brendshëm dhe Auditimit në FKEE në përputhje me standardet, normat e vlefshme dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Të promovojë kulturë etike në ushtrimin e profesionit të kontrollit të brendshëm duke respektuar parimet fundamentale dhe rregullat e sjelljes të përcaktuara me Kodin e Etikës (Integriteti, Objektiviteti, Konfidencialiteti, Kompetenca, etj.).

C) Detyrat dhe funksionet specifike si dhe rezultatet e pritshme kryesore

Zyrtari i Kontrollit të Brendshëm është përgjegjës për sa vijon:

- Të rrisë dhe mbroj vlerën e FKEE-së duke ofruar siguri dhënie përmes kontrollit të brendshëm dhe këshillë dhënies të bazuar në rrezik dhe objektiva.
- Kryen kontrolle të saktësisë, vërtetësisë dhe gjithë përfshirjes së evidencës së

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë / Kosovo Energy Efficiency Fund

Adresa: Luan Haradinaj p.n Ish-Banka e Lubjanës Kati 7, 10 000 Prishtinë – Republika e Kosovës

Address: Former Ljubljana Building, 7th floor, 10 000 Prishtina – Republic of Kosova

Tel: +383 (0) 38 223 777



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

kontabilitetit dhe të raporteve financiare të FKEE-së;

- Siguron një mjedis të fortë të kontrollit të brendshëm, përmes zhvillimit të politikave, procedurave, rishikimin e tyre në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe sigurimi i zbatimit të tyre;
- Kryen kontrole për të siguruar se veprimtaria e organizatës është duke funksionuar në pajtueshmëri me ligjet, aktet nënligjore dhe procedurat e brendshme të FKEE-së.
- Vlerëson sistemin e menaxhimit të rrezikut dhe masat për zvogëlimin e rrezikut që të arrihen objektivat e FKEE-së;
- Rishikon efektivitetin e dizajnit të kontrollit të brendshëm dhe rekomandon menaxhmentin për përmirësime sipas nevojës.
- Kryen kontrole të brendshme para ndodhjes (ex-ante) për të parandaluar rrezikut për parregullsi dhe mashtrimet brenda organizatës.
- Harton politika dhe ushtron funksionin e kontrollit të brendshëm sipas Standardeve Ndërkombëtare - Kuadrit të Kontrollit të Brendshëm.
- Harton dhe propozon planin vjetor për vitin vijues të kontrollit të brendshëm të FKEE-së për shqyrtim dhe miratim nga organi përgjegjës.
- Planifikon proceset përmes së cilave vlerësohen kontrollet e brendshme dhe performaca, në pajtueshmëri me standardet profesionale;
- Përgatit dhe ekzekuton programe të kontrollit sipas planit vjetor duke përcaktuar objektivat e kontrollit bazuar në rrezik, kohëzgjatjen, metodologjinë e qasjes, llojin e kontroleve (ex-ante, ex-post), etj.

Ai/Ajo gjithashtu është përgjegjës për sa vijon:

- Përgatit raportet e kontrollit të brendshëm që pasqyrojnë qartë objektivat, fushëveprimin, gjetjet, rekomandimet, konkluzionet;
- Kryen Ad-hoc kontrole të brendshme dhe detyra tjera me kërkesën e DM-së;
- Siguron dokumentimin e letrave të punës sipas metodologjisë së aprovuar;
- Ndhmon në ruajtjen e kontroleve efektive përmes
- Ndhmon në vlerësimin dhe përmirësimin e qeverisjes përmes:
- Demonstron integritet, kompetencë dhe kujdesin e duhur profesional.
- Është objektiv dhe i pavarur, përshtatet me strategjinë, objektivat dhe rreziqet e FKEE-së.
- Është proaktiv dhe i fokusuar në të ardhmen që të rekomandoj dhe këshillojë përmirësim e kontrollit të brendshëm të FKEE-së.

D) Kualifikimet, përvoja dhe aftësitë gjuhësore

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë përgatitje të lartë - Fakulteti Ekonomik, Juridik, Financa Publike, kontabilitet, fusha të tjera përkatëse të studimit (për kandidatët e diplomuar jashtë Kosovës, duhet të sigurohet prova e njohjes së diplomës në Kosovë);
- Të ketë pesë (5) vjet përvojë pune të përgjithshme profesionale, nga të cilat së paku tri (3) vite përvojë (pas diplomimit) në detyra të ngjashme si në Auditim i brendshëm, Kontroll të Brendshëm, ose fushën e Financave;
- Të posedojë Certifikatën për Auditor të Brendshëm ose Certifikatën si Zyrtar i Kontrollit të Brendshëm, lëshuar nga institucionet e akredituara në Kosovë ose organizatat vendore dhe ndërkombëtare të Akredituara;



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

- Të zhvillojë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale, dhe ruajnë certifikimin e profesional duke marrë pjesë në gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) vite të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin në nenin 25 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L021
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme për të paktën një nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Posedimi i shkathtësisë informatike në Aplikacionet MS (Word, Excel, PowerPoint, etj.);
- Nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për një vepër penale për të cilën dënimi maksimal tejkalon gjashtë (6) muaj burgim dhe dënimi nuk është i kushtëzuar; (evidencat nuk duhet të jenë më të vjetra se data e shpalljes së vendeve të punës të kësaj njoftimi për vendet e lira të punës).

E) Shpërblimi

Sistemi i pagave: Shpërblimi bëhet sipas pakos konkurruese në përputhje me Rregulloren e Brendshme për Shpërblimin e Personelit të FKEE (R-OBPSH).

F) Të dhëna tjera

- FKEE nuk është organizatë buxhetore, marrëdhënia e punës themelohet sipas Ligjit të Punës.
- Për më shumë detaje rreth FKEE: <https://fkee-rks.net/>

1. Përmbajtja e dokumenteve të aplikimit

Dokumentet e aplikimit duhet të përmbajnë së paku:

- 1) Kopja e dokumentit përkatës që dëshmon shtetësinë.
- 2) CV-në e hollësishme të aplikuesit
- 3) Letrën e motivimit përfshirë vizionin e aplikuesit për punën e Zyrtarit të Kontrollit të Brendshëm gjatë kohës së mandatit (jo më shumë se 3 (tri) faqe).
- 4) Kopje të diplomës (diplomave) për studimet e mbaruara universitare, përfshirë dëshminë e njohjes së diplomës (nëse aplikohet)
- 5) Certifikatën për auditor të brendshëm ose certifikatën si zyrtar i kontrollit të brendshëm
- 6) Kopje të dëshmisë se nuk ka qenë i dënuar (shiko kushtet e hollësishme në Seksionin D më lart)

Dokumentet e aplikimit mund të përgatiten në secilën prej tre (3) gjuhëve: shqip, serbisht ose anglisht. Kopjet e çfarëdo dëshmie që tregon për kualifikimet, përvojën dhe aftësitë gjuhësore të aplikuesve janë të mirëseardhura.

2. Dorëzimi i aplikacioneve

Aplikimet, përfshirë të gjitha dokumentet e kërkuara, dorëzohen në info@fkee-rks.net deri më **05.12.2022, ora 16.00.**

Aplikacionet që nuk i kanë të gjitha dokumentet e parapara (1-6 më lart) nuk do të merren parasysh nga komisioni vlerësues.